



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republike of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality
Zyra e Kryetarit/Kancelarija Predsednika/President office

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Në bazë të nenit 12 pika d), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/15, 28 qershor), neni 5, neni 6 paragrafi 1.1 dhe neni 14 pika 3, i Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe këmbimin e Pasurisë së Paluajtshme Komunale, (Ligji nr. 06/L-092 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 03.04.2019), në bazë të nenit 4 dhe neni 8 i Rregullores së QRK-së 09/2020 për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 32 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr. 06 - 103/1 të datës 11.09.2008, në seancën e VII-të të Kuvendit të Komunës së Dragashit e mbajtur më dt. 28.04.2022, pas shqyrtimit dhe votimit paraprak miratohet ky:

VENDIM

**PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË
PATUNDSHMËRISË KOMUNALE**

Neni I

- 1.1 Jepet në shfrytëzim afatshkurtër Byfeja komunale e cila gjendet në objektin e Komunës – parcela kadastrale P-70604014-00809/1, me sipërfaqe prej 15 m²,
- 1.2 Jepet në shfrytëzim lokal afaristë, deri tash i regjistruar me emrin “Morena” në kuadër të ndërtesës në ngastrën Kadastrale P-70604014-00781-0/ -10-2-1-0, ZK Dragash, Rruga e Dëshmoreve p.n. Dragash, në Sipërfaqe prej: 39m² lokal dhe 21m² depo, gjithsejtë 60m²,
- 1.3 Jepet në shfrytëzim lokal afaristë, deri tash i regjistruar me emrin “Jeta Pharm” në kuadër të ndërtesës në ngastra. Kadastrale P- 70604014-00781-0/ 0-10-2-3-0 ZK Dragash, Rruga e Dëshmoreve p.n. Dragash, , në Sipërfaqe prej: 27.3m² lokal dhe 16m² depo, gjithsejtë 43,3m².

Neni II

Afatati i shfrytëzimit të pronave të lartcekura është 10 (dhjet) vite nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes.

Neni III

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës, gjenerimi i të ardhurave.....

Neni IV

Procedura për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për dhënien afatshkurtër në shfrytëzim do të jepet nëpërmjet ankandit publik nga komisioni vlerësues, ku do të caktohen kushtet për aplikim, çmimi fillestar etj.

Neni V

Të drejtat dhe detyrimet e shfrytëzuesit të ardhshëm të byfesë do të caktohen në marrëveshjen e cila do të lidhet, duke pas parasysh legjislacionin në fuqi (ligjet financiare, tatimore etj.).

Neni VI

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Komisioni Vlerësues dhe sipas nevojës dhe autoriteti kompetent

Neni VII

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në protokollin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës së Dragashit.

I dërgohet:

- MAPL-së (zyra ligjore) – Prishtinë;
- Komisionit për vlerësim, të gjithë anëtarëve;
- Drejtoratit për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim;
- Arkivit;

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

01Nr. 060/01-7575-4/22

Dt. 28.04.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Uran Halimi

